



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 216/ 8 prot

Datë 22.02.2024

V E N D I M
Nr. 216/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.02.2024, me;

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK” në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001, Tiranë.
- Ankimues:** BOE "Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK" SHPK, me NIPT: L222180133G, me adresë: Rruga "Dritan Hoxha", Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik "ALTEC" SHPK me NIPT: K57923807Ë, me adresë: *Njësia Administrative "Fratari", Fshati "Ninesh", Rruga "Qendër", Godina Nr.15, Ballsh "Mallakastër", Ballsh, Fier.*
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj*”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë*”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 22.01.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK*”, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij për arsyet e mëposhtme:

“Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 dhe 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën se merr përsipër kryerjen e punimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo ore gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dhe deklaratën për Agregatet/Pajisjet/Pjesët e këmbimit të cilat duhet të ofrohen te reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi.”.

II.3. Në datën 30.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 216 protokollit, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK*” për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj*”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë*”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara. Referuar Informacionit nr. 136/1 prot., datë 02.02.2024, protokolluar me tonën nr. 216/4 Prot., datë 05.02.2024, operatori ekonomik ankimues ka depozituar ankesën e tij në autoritet më datë 30.01.2024.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, konstatohet, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK*”. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ecs Eco Climate Solution*

SHA & Edemeli SHPK”, kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK.

II.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 216/3, datë 31.01.2024, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”, si dhe lidhur me pretendimin e ankimuesit për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.5. Autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE, si dhe nuk e ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 139/4 prot, datë 07.02.2024, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, protokolluar me tonën me nr. 216/5 prot, datë 08.02.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 29.12.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

III.1.1. Referuar materialeve të depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 22.01.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA &

Edemeli SHPK”, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 dhe 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën se merr përsipër kryerjen e punimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo ore gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dhe deklaratën për Agregatet/Pajisjet/Pjesët e këmbimit të cilat duhet të ofrohen te reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi”.

III.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk ka publikuar ende njoftimin e fituesit apo njoftimin e anulimit.

III.1.3. Në datën 30.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 216/2024 protokoll, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, konstatohet, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK” kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 216/3 Prot., datë 31.01.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”, dhe kriteret mbi të cilat ankimuesi pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK.

III.1.5. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar ende në SPE, njoftim fituesi paraprak apo njoftim anulimi.

III.1.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**”.

III.1.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit

Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar ende në SPE, njoftimi i fituesit apo njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ndërkohë që bashkimi i operatorëve ekonomik “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli” SHPK, ka dorëzuar ankesën për procedurën e mësipërme të prokurimit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 30.01.2024 dhe pranë autoritetit, më datë 30.01.2024.

III.19. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues

ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit (anulimit) dhe përfundon në ditën e 7-të. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e administruar në datën 30.01.2024, si në autoritet kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit Prokurimit publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se:

“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar si pranë KPP ashtu dhe pranë AK, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - Shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrit”, me fond

limit 35,977,266 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli”, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

